

TIRANA LOGISTIC PARK SH.P.K.

AUTOSTRADA TIRANE - DURRES KM. 5, RRUGA GRYKA E KAÇANIKUT, MBRAPA FABRIKES COCA - COLA,  
NUIS K81715012B

---

VENDIM

i

ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më datë 12.12.2022 (dy mijë e njëzet e dy), në orën 10.30, në selinë e Shoqërisë Tirana Logistic Park Sh.p.k. regjistruar më regjistrin tregtar me nr identifikimi K81715012B (më tej referuar si "Shoqëria"), me adresë Autostrada Tirane - Durrës Km. 5, Rruga Gryka e Kaçanikut, mbrapa fabrikes Coca - Cola, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me të pranishëm:

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT K72223031K dhe seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II", ABA Business Center, Kati 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori i saj Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 03.02.1983, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e lëtërnjoftimit me Nr. 034271384, - ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% (njëqind përqind) të kuotave të kapitalit themeltar të saj

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Eva Veizaj, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaron vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaron Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dyte të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

RENDI I DITËS

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË;
- II. TE NDRYSHME;

\*\*\*\*\*

I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm parashtron se Kapitali aktual i Shoqërisë është **1.920.526.117,00 LEK** ( një miliard e nëntëqind e njëzet milion e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë lekë) i ndare respektivisht kontribut ne para ne vleren prej 1.047.401.117,00 LEK (një miliard e dyzet e shtatë milion e katërqind e një mijë e njëqind e shtatëmbëdhjetë Lek) dhe kontribut ne natyre ne vleren prej 873.125.000,00 Lek (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e pesë mijë Lek).

Për motive operacionale është parë e arsyeshme zvogëlimi i tij me 482.616.720,00 LEK (katërqind e tetëdhjete e dy milion e gjashtëqind e gjashtëmbedhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë lekë). Pas zvogëlimit kapitali i ri i shoqërisë do të jetë 1.437.909.397,00 LEK ( një miliard e katërqind e tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) i ndare respektivisht kontribut ne para ne vleren prej 564.784.397,00 LEK (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjete e katër mijë e treqind e nëntedhjetë e shtatë lekë) dhe kontribut ne natyrë ne vleren prej 873.125.000,00 Lek (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e pesë mijë Lekë).

Pas një shqyrtimi të kujdeshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë me **482.616.720,00 LEK** (katërqind e tetëdhjete e dy milion e gjashtëqind e gjashtëmbedhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë lekë)
- B. Kapitali i ri i shoqërisë do të jetë **1.437.909.397,00 LEK** ( një miliard e katërqind e tridhjetë e shtatë milion e nëntëqind e nëntë mijë e treqind e nëntëdhjetë e shtatë lekë) i ndarë respektivisht kontribut ne para ne vleren prej **564.784.397,00 LEK** (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e nëntedhjetë e shtatë lekë) dhe kontribut ne natyrë ne vleren prej **873.125.000,00 Lek** (tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e njëzet e pesë mijë Lek) ;
- C. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme online me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht ose nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë për këtë qëllim.

\*\*\*\*\*

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjeter për të diskutuar, Kryetari e deklaron mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.00. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

\*\*\*\*\*

BALFIN - BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SH.P.K.

ZNJ. EDLIRA MUKA  
PËRFAQËSUES LIGJOR

*Edlira Muka*  
Business Center, Pali Ipa  
Nj. 10, Tirana  
Tel: K722-303JK

SEKRETAR

ZNJ. EVA VEIZAJ

